



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 569 prot

Roskovec, më 30/01/2023

VENDIM

NR. 11 .DATË 27.01 .2023

**“PËR MIRATIM TË PROJEKTEVE PRIORITETARE PËR BASHKINË
ROSKOVEC ”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 54, germa k, si edhe të Ligjit Nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, te ligjin 107/2014, datë 31.07.2014 ”Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, dhe VKM nr 686, date 22.11.2017, ”Per miratimin e rregullores se planifikimit te territorit”, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Miratimin e projekteve prioritare për bashkinë Roskovec, për vitin 2023. Këto nevoja kanë lindur pas kontrolleve në terren të grupit teknik të Bashkisë Roskovec dhe ekspertëve të jashtëm në periudha të ndryshme të vitit si dhe nga eksperiencat e mëparshme të fatkeqësive natyrore.
2. Projektet prioritare janë si më poshtë:
 - 1- Nderhyrje per sigurine e rezervuarit Ngjeqar.
 - 2- Permiresimi i shkarjeve ne rrugen “Gjonaj-Fetanaj-Pocest”.
 - 3- Marrja e masave për transferimin e banorëve të zonës së shkarjes Mbërs.
 - 4- Rritja e sigurisë së argjenaturës përgjat “lumit Seman”
 - 5- Rehabilitimi Urban i një pjese të bllokut nr. 3 në qendër të qytetit Roskovec, (faza I)
 - 6- Ndëtimi i Postës së Policisë Roskovec
 - 7- Ndërtimi i tregut agro-ushqimor dhe rrugës lidhëse për to.
 - 8- Pikë përpunimi të ndarë, ambalazhim dhe grumbullim të vajit të ullirit.
 - 9- Linjë përpunimi të perimeve të fushës dhe përpunim i produktit ndryshe.

- 10- Studim, mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga vend-depozitimet ilegale Roskovec.
- 11- Rikonstrukcion i shkollës 9-vjecare "Rexhep Kothere"
- 12- Sistemi fotovoltaik për vetkonsum në stacionet e pompimit Arapaj, Metushaj, Jagodinë.
- 13- Pikë grumbullimi dhe seleksionimi të mbetjeve bimore me destinacion Inceneratorin Fier.
- 14- Rivitalizimi i pyllit të Luarit.
- 15- Pyllëzimi i brezit tëgjelbër, Suk-Jagodine-Marinez.
- 16- Sistem fotovoltaik për ngrohje nëgodinat e arsimin parauniversitar.
- 17- Rehabilitim e sistemimi i "Përroit Vidhishtë".
- 18- Rivitalizimi i "Liqenit të Kurjanit" dhe lidhja e tij me "Kishen e Kurjanit" dhe "Pyllin e Luarit"
- 19- Rehabilitimi i ish Bashkisë së Roskovecit (Muzeu Historik)
- 20- Rijetëzim i ambienteve sportive në Bashkinë Roskovec.

3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

